

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/B: 209/17
Datë/Datum: 07.07.2017

PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: K.R.U "Radoniqi" SH.A

(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: KRURGJA-17-1963-1-2-1

(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për Furnizim me kemikale -klor te gazte dhe klor te lëngjet

(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NTSH SEYKOS SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. 28 Nëntori

(Adresa)

Prishtinë

10000

(Vendi) (Kodi postar)

[REDACTED]

n/a

(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it)

Shpejtim Kuçi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

[REDACTED]@yahoo.com

(Adresa elektronike)

06.07.2017

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni: 59
Neni: 60
Neni: 62
Neni: 72
Neni: 4.1.26
Neni: 56.3
Neni: 108/A

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohej si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Përshkrimi:

Ne SEYKOS Shpk, kemi dorëzuar tenderin e sipër përmendur në datë dhe kohë të paraparë. Në ditën e hapjes së tenderit kemi dal me Cmimin më të ulët sipas Neni 31.1 në FTD – Kriteret e Dhënies.

Me datë 12.06.2017 është bërë njoftimi për dhënie të kontratës dhe kompania e jonë është shpallur fituese e tenderit ku edhe AK e ka bërë publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës në web faqen e Krpp-së.

Me datë 15.06.2017, kemi pranuar njoftimin për pezullimin e aktivitetit të prokurimit dhe me datë 16.06.2017 kemi pranuar Kërkesë për sqarim të tenderit.

Pasi kemi pranuar letrën standarde të tenderuesit të eliminuar, ne kemi parashtruar kërkesën për rishqyrtim me pretendimet tona për të cilat Autoriteti kontraktues, nuk ka dhënë përgjigje për të gjitha pretendimet e parashtruara.

Provë i bashkangjesim kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK.